



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Nivelo Org. Org. Jedin Org. Unit	01	Nr. Prof. Er. Prof. Prof. No.	7203
Nr. i fazeve Broj stranic No. pages	12	Data Datum Date	29.12.23
PRISHTINE A			NO.1

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Ministria e Ekonomisë  
Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy


<b>DATË/A:</b>	29.12.2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Luan Morina, UD. Drejtor Ekzekutiv, SHGJK
<b>CC:</b>	Leonita Shabani, UD. Sekretare e përgjithshme, ME
<b>PËRMES:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Artane Rizvanolli, Ministre, ME
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Aprovimi i Planit të Performancës së SHGJK-së për vitin 2024



I nderuar z. Morina,

Përmes kësaj shkrese ju njoftoj se miratohet Plani i Performancës së ShGjK-së për vitin 2024.

Me respekt!



SHËRBIMI  
GJEOLOGJIK  
I KOSOVËS  
GEOLOGSKA SLUŽBA  
KOSOVA  
GEOLOGICAL SERVICE OF KOSOVO

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije /Ministry of**  
**Economy**

<b>DATË/A:</b>	01.12.2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Znj. Artane Rizvanolli, Ministre, ME <i>Artane</i>
<b>CC:</b>	Znj. Leonita Shabani, UD. Sekretare e përgjithshme, ME
<b>PËRMES:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Luan Morina, UD. Drejtor Ekzekutiv, SHGJK
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Shkresë Njoftuese – Finalizimi i Planit të Performances së SHGJK-së për vitin 2024



E nderuara Znj. Ministre

Sipas kërkesës së Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, në vijim keni Planin e Performances së SHGJK-së për vitin 2024, i finalizuar dhe i cili do të duhet të miratohet nga ana e juaj, më së largu deri me datën 31. Dhjetor 2023.

Me respekt!



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije/Ministry of**  
**Economy**



SHËRBIMI  
**GJEOLGJIK**  
I KOSOVËS  
GEOLOGIJSKA SLUŽBA KOSOVA  
GEOLOGICAL SERVICE OF KOSOVO

---

**PLANI I PERFORMANCËS  
TË SHËRBIMIT GJEOLGJIK TË KOSOVËS  
PËR VITIN 2024**

## A. Pjesa përshkruese e Planit të Performancës

### 1. Përmbledhje Ekzekutive

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, bazuar në Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, ndërsa bazuar në Ligjin Nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, Rregulloren Nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës është përgjegjëse për:

- 1.1 kryerjen e hulumtimeve themelore gjeologjike dhe hulumtimeve aplikative gjeologjike;
- 1.2 kryerjen e studimeve gjeologjike sistematike bazë në tokë, në liqene, nëpërmjet hartografimeve komplekse të shkallëve të ndryshme;
- 1.3 kryerjen e studimeve gjeokimike dhe përpilimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme, si dhe plotësimin e hartave ekzistuese me informacione të reja;
- 1.4 kryerjen e studimeve të thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë;
- 1.5 kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve gjeofizike të çdo shkalle me qëllim të studimit të korës së tokës në ose në afërsi të sipërfaqes së tokës;
- 1.6 kryerjen e studimeve për promovim të perspektivës së mineraleve të dobishme dhe vlerësimin ekonomik të tyre;
- 1.7 kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve hidrogjeologjike, ujërave nëntokësore, ujërave minerale dhe gjeotermal;
- 1.8 kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve gjeologo-inxhinierike dhe të gjeorrezizive;
- 1.9 kryerjen e studimeve gjeologjike komplekse për gjeomjedisin në funksion të planifikimit të territorit;
- 1.10 kryerjen e studimeve dhe vlerësimeve të gjeomonumenteve;
- 1.11 kryerjen e hulumtimeve dhe vlerësimeve të mineraleve metalore, jo metalore, energjetike, hidrokarbureve, mineraleve industriale, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar;
- 1.12 kryerjen e hulumtimeve dhe studimeve të përgjithshme paleontologjike, stratigrafike, sedimentologjike, petrografike, mineralogjike, kimike, gjeomorfologjike, gjeodinamike, gjeologjiko strukturore dhe gjeostatistike;
- 1.13 përpilimin apo plotësimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme, harta gjeologjike tematike (metalogjenike, mineralmbajtëse, gjeokimike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, strukturo-tektonike, sizmike, gjeomonumenteve, gjeoekologjike, përfshirë edhe përgatitjen e bazës gjeologjike për nevojat e planifikimit hapësinor, hulumtime dhe monitorimin e rrëshqitjeve të tokës, përgatitjen e hartave gjeologjike të rrezikut, hulumtimet regjionale gjeofizike, analiza dhe hulumtime laboratorike në fushat e mineralogjisë, petrografisë, sedimentologjisë, paleontologjisë, kimike, analiza gjeomekanike;
- 1.14 kryerjen e studimeve dhe punimeve zhvillimore, të hulumtimeve gjeo-shkencore dhe projekte ndërkombëtare në fushën e gjeologjisë, studimin e ujërave nëntokësore në bazë të programeve të veçanta, mbledhjen, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave



dhe dokumentacionit teknik me interes për sistemin e bazës së të dhënave gjeologjike të Republikës së Kosovës;

1.16. krijimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave gjeologjike, e cila duhet të jetë në dispozicion të Qeverisë si dhe subjekteve të tjera të interesuara për hulumtime gjeologjike;

1.17. ofron analiza objektive dhe të paanshme për autoritetet publike dhe organizatat e sektorit privat brenda fushës së ekspertizës së SHGJK-së;

1.18. promovon kristalet e mineraleve, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar të Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça";

1.19. krijon, mirëmban, pasuron dhe zgjeron bazën shtetërore e të dhënave për kristalet dhe mineralet, fosilet, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar;

1.10. hulumtime dhe studime mbi zvogëlimin e ndotjes së mjedisit nga aktivitetet minerare;

1.11. menaxhon me rrjetin Sizmologjik të Kosovës, monitoron aktivitetin sizmik të vendit dhe rajonit, bën studime makro dhe mikro sizmologjike sipas kodeve të aplikuara në Kosovë, si dhe detyra dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, përgjegjëse për sektorin e gjeologjisë, për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë themelore të saj, të përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe legjislacionin në fuqi, Planin e Performancës për vitin 2024, e ka përgatitur duke marrë parasysh burimet njerëzore dhe teknike në dispozicion si dhe mundësitë financiare.

## 2. Hyrje

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, ka hartuar Planin e Performancës, duke u bazuar në Rregulloren (QKR) nr.12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, në përputhje me Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Plani i Performancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, ndërlidhet me objektivat e punës së Ministrisë së Ekonomisë, mandatin dhe përgjegjësitë ligjore të përcaktuara me Ligjin për shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe dokumentet e politikave sektoriale.

Për të ngritur përformancën e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, në këtë Plan të Performancës janë planifikuar (6) gjashtë objektiva, të cilat konsiderohen të domosdoshme, të ndarë në dy pjesë, pjesa përshkruese dhe pjesa tabelore, e hartuar sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Rregulloren (QKR) Nr.12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, në përputhje me Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Përmes objektivave të planifikuar në këtë Plan të Performancës, synohet të arrihen treguesit si në vijim:

- Projekti Kadastrit i paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit
- Digjitalizimi i shërbimit dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve për vektorizimin e hartave

- Studimi kimik dhe mineralogjik i rrjedhave lumore – në lumenjtë Ibër dhe Lushta
- Monitorimi dhe raportimi rekomandues për vlerësimin e rrëshqitjeve
- Mbledhja përpunimi dhe ekspozimi i kristaleve/mineraleve të reja në Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça".
- Promovimi i kristaleve/mineraleve në Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça".
- Harta vjetore Sizmike
- Funksionalizimi dhe Akreditimi i Laboratori Gjeologjisë
- Përfshirja e SHGJK ne kuadër të Projektit të GSEU

Për realizimin e këtij Plani të Performancës për vitin 2024, sfidë mund të konsiderohet numri tejet i vogël dhe i pamjaftueshëm i stafit profesional, niveli i tyre profesional si dhe domosdoshmëria që kapacitet analitike / shërbimet do të duhen të jen të standardizuara.

### 3. Përmbledhje e Objektivave

Objektivat e përcaktuara për vitin 2024 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, janë si në vijim:

- Objektiv 1. Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialeve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës;
- Objektiv 2. Sedimentologjia e rrjedhave lumore si dhe monitorimi i rrëshqitjeve në nivel vendi
- Objektiv 3. Pasurimi dhe Promovimi i mëtejshëm i Kristaleve dhe Mineraleve në Muzeun Shtetëror "Trepça"
- Objektiv 4. Përpilimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sizmik.
- Objektiv 5. Konsolidimi i mëtejshëm i kapaciteteve kuadrovike, teknike dhe administrative me qëllim të integritetit të SHGJK-së, në iniciativat regjionale për hulumtime gjeologjike

#### **Objektiv 1. Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialeve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës**

Përmes këtij objektiv, synohet përmbledhja në tërësi e informacioneve të nevojshme për të gjitha paraqitjet xeherorë të kromit të cilat janë të njohura nga koha e zbulimit të tyre. Për tu arritur një objektiv i tillë është e nevojshme krijimi i kadastrit i cili do të mbulon tërë pjesën tektonike të Sharrit, i cili do të krijohet duke shfrytëzuar gjithë dokumentacionin gjeologjik ekzistues të hulumtimeve nga e kaluara, dhe përmes punimeve me rilevim direkt në terrenet ku ato janë të evidentuara.

Hapësira e cila do mbulohet ka shtrirje prej Hanit të Elezit deri në Kufirin Kosovë-Shqipëri derisa në gjerësi kap hapësirën prej kufirit Kosovë Maqedoni e Veriut gjerë në Zonat kadastrale të Ferizajt, Suharekës dhe Prizrenit.

Aktivitetet që planifikohen me qëllim të realizimit të këtij objektiv janë:

- Shqyrtimi i dokumentacioneve ekzistuese nga hulumtimet gjeologjike në të kaluarën;
- Punimet fushore;



- Punimet kabinetike.

Lidhur me aktivitetin e parë, përkatësisht shqyrtimin e dokumentacioneve ekzistuese nga hulumtimet gjeologjike në të kaluarën, do të bëhet identifikimi i dokumenteve relevante ekzistues në posedim të Shërbimit Gjeologjik i Kosovës si dhe institucionet tjera relevante. Pas identifikimit, do të behët adaptimi i të dhënave të nevojshme, për të vazhduar tutje me verifikimin e tyre në teren. Ndërsa sa i përket aktivitetit të dytë dhe të tretë të këtij objekti, përmes shkeljes së terrenit, dhe punimeve kabinetike, do të:

- Identifikohet numri i paraqitjes xeherore në korrelacion me numrin e hartës( nëse ekziston);
- Evidentimi i të gjitha vendburimeve të kromit të studiuara/ hulumtuara deri me tani
- Identifikimi i numrit të paraqitjes xeherore në korrelacion me numrin e hartës (nëse ekziston);
- Verifikimi i koordinatave qendrore të paraqitjes xeherorë;
- Përshkrimi i shkëmbinjve rrethues, karakteristikave fizike të paraqitjes, vëllimi i paraqitjes xeherore dhe i nivelit të zbulimit.

Ky objektiv si tërësi planifikohet të përfundoj si tersi deri në fund të vitit 2024. Ky objektiv, do të realizohet nga nëpunësit e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe nuk paraqet implikime buxhetore shtesë.

#### **Objektivi 2: Sedimentologjia e rrjedhave lumore si dhe monitorimi i rrëshqitjeve në nivel vendi.**

Detyre e Departamentit të Sedimentologjise ne vitin 2024, do të jete në mes të tjerash edhe finalizimi i studimit kimik dhe mineralogjik i rrjedhave lumore në lumin Ibër dhe Lushta, e i cili do të realizohet përmes një grupi punues përkatës, e themeluar me vendim te veçante.

Gjithashtu, një aktivitet tejet i rëndësishëm i këtij departamenti do të jetë edhe procesi i monitorimit dhe përgatitja e raporteve rekomanduese për vlerësimin e rrëshqitjeve.

#### **Objektivi 3: Pasurimi dhe Promovimi i mëtejme i Kristaleve dhe Mineraleve në Muzeun Shtetëror “Trepça”**

Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”, posedon një numër të madh të kristaleve/mineraleve të mbledhur nder vite, mirëpo pasurimi i muzeut me kristale/minerale të reja, është domosdoshmëri, marr parasysh së fondi ekzistues i kristaleve/mineraleve me përbërje metalore sulfide ndikohen nga oksidimi me pasoj shkatërrimi. Andaj përmes këtij objekti, do të bëhet pasurimi i fondit ekzistues të kristaleve/mineraleve me strukturë të mirë dhe të veçantë kristalore, dhe po ashtu do të zëvendësohen kristalet tashme të oksiduara dhe të cilat nuk kanë vlerë reprezentative.

Ky objektiv do të realizohet përmes aktiviteteve që lidhen me mbledhjen e kristaleve/mineraleve të reja, përpunimin dhe pastrimin e tyre, me qëllim të ekspozimit në sirtarët përkatës të hollit të muzeut, në funksion të promovimit të tyre të mëtejme në Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça.

#### **Objektivi 4: Përpilimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sizmik.**

Detyra e Departamentit të Sizmologjisë në vitin 2024, do të jete në mes të tjerash do te jete Monitorimi dhe mirëmbajta i rrjetit sizmik dhe atë duke nënkuptuar edhe Analizimin dhe përpunimin e te dhënave sizmologjike me qëllim të përpilimit te hartës vjetrore sizmike.

**Objektivi 5: Konsolidimi i mëtejme i kapaciteteve kuadrore, teknike dhe administrative me qëllim të integritit të SHGJK-së, në iniciativat regjionale për hulumtime gjeologjike**

Për pjesën e parë të detyrave që lidhen me objektivi në fjalë, konkretisht detyra që lidhet me digjitalizimin e shërbimit dhe ngritja e kapaciteteve përkatëse, njësi përgjegjëse është Departamentit të Gjeoinformacionit, ku me këtë rast planifikohen të realizohen duke ndërmarr aktivitetet si në vijim:

- Zhvillimi i procedurave për furnizim –blerjen e 1 (një) Softuer Arc GIS së bashku me licencën përkatëse
- Trajnimi i stafit me softuerin Arc GIS si dhe digjitalizimin e hartave ekzistuese

Pjesa e dytë e detyrave që lidhet me Laboratorin të Gjeologjisë në vitin 2024 , si strukture e re e krijuar tashme do të jetë zhvillimi i procedurave për plotësimi me staf profesional si dhe të trajnimit/ certifikimit te tyre, me qëllim të plotësimit të kërkesave/ standardeve për qëllime të akreditimit sipas rekomandimeve të DAK

Ndërsa, pjesa e trete do të lidhet me detyrat e përgjithshme e të gjithë strukturave të SHGJK-së, do të jetë edhe definimi i fushave hulumtuese si parakusht per zhvillimin e procedurave përkatëse dhe nënshkrimi i marrëveshjes për përfshirjen në projektin GSEU

Në vijim, paraqitja tabelore e elaboruar edhe me kostot dhe referencat përkatëse sqaruese për secilin objektiv të përfshirë për vitin 2024.



I  
Plani i Performancës

Data:	30.11.2023						
AGJENCIA	SHËRBIMI GJEOLLOJIK I KOSOVËS						
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	MINISTRIA E EKONOMISË						
Misioni i Agjencisë	Mision i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës është zbatimi i ligjit për të gjitha aktivitetet e kryera, që përfshinë hulumtimet, kushtet dhe mënyrën e kryerjes së hulumtimeve gjeologjike, programimin dhe organizimin e hulumtimeve gjeologjike me interes për Republikën e Kosovës.						
Objektivat	Treguesi(t)	Vlera bazë	Vlera e synuar	Rezultatet (Autputet)	Aktivitetet kryesore	Alokimi financiar	Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike
1. Identifikimi dhe evidentimi i mëtejme i potencialëve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës	Projekti Kadastri i paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit, i përfunduar.	1	2	1.1 Evidentimi i të gjitha vendburimeve të kromit të studiuara/hulumtuara deri me tani 1.2 Punimet fushore 1.3 Punimet kabinetike.	1.1 Shqyrtimi i dokumentacionit gjeologjik nga e kaluara 1.2 Punimet fushore 1.3 Punimet kabinetike.	21438,00 €	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (2012-2025)/ Ligji Nr. 06 L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës/ Dokumentet ekzistuese gjeologjike / si dhe burime të tjera relevante

<sup>1</sup> Buxheti i përartërt për pagave të statit përkates të involvuar në projekt (1\*8.3 + 3 (S)\*7)\* koeficienti \*10 muaj) si dhe shpenzimet tjera relevante që kryesisht lidhen me transportin.

Faqe 7 nga 10

			<p>xehorë; 1.4 Përshkrimi i shkëmbinjve rrethues, karakteristikave fizike të paraqitjes, kimizimin, vëllimi i paraqitjes xehore dhe i nivelit të zbulimit.</p>			
<p>2. Sedimentologjia e rrjedhave lumore si dhe monitorimi i rrëshqitjeve në nivel vendi</p>	<p>2.1 Studimi kimik dhe mineralogjik i rrjedhave lumore – në lumenjtë Iber dhe Lusha, i realizuar</p> <p>2.2. Monitorimi dhe raportimi rekomandues për vlerësimin e rrëshqitjeve, i realizuar</p>	<p>4</p>	<p>6</p>	<p>2.1 Studimi kimik dhe mineralogjik i rrjedhave lumore në lumen Iber dhe Lusha,</p> <p>2.2. Monitorimi dhe përgatitja e raporteve rekomanduese për vlerësimin e rrëshqitjeve</p>	<p>25110,00 €<sup>2</sup></p>	<p>Ligji Nr. 06 L-039 për Sherbimin Gjeologjik të Kosovës/ Dokumentet ekzistuese gjeologjike / si dhe burime të tjera relevante</p>

<sup>2</sup> Buxheti i përafërt për pagave të stafit përkatës të involvuar në zhvillimin e aktiviteteve përkatëse (4\*7(S))\* koeficienti \*12 muaj, si dhe shpenzimet tjera relevante që kryesisht lidhen me transportin.

<p>3. Pasurimi dhe Promovimi i mëtejme i Kristaleve dhe Mineraleve në Muzeun Shtetëror "Trepça"</p>	<p>3.1. Mbledhja ekspozimi i kristaleve/mineraleve të reja në Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça", i realizuar</p> <p>3.2. Promovimi i kristaleve/mineraleve në Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça", i realizuar</p>	<p>1</p>	<p>2</p>	<p>Kristalet/mineralet e mbledhura nga vendburimet ndryshme, do të ekspozohen në hapësirat përkatëse të muzeu në mënyrë që të behet e mundur zëvendësimi i kristaleve/mineraleve të demtuara dhe pasurimi i Muzeut me kristale/mineralet e të reja.</p>	<p>3.1 Mbledhja e kristaleve/mineraleve të reja, nga territori i Kosovës nëpër arsye të pasurimit dhe zëvendësimit të fondit ekzistues dhe i cili është demtuar nga oksidimi.</p> <p>3.2 Përpunimi dhe pastrimi i kristaleve dhe mineraleve si dhe ekspozimi në shtatë përkatës të hollit të muzeut.</p>	<p>24993,00 €<sup>3</sup></p>	<p>Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (2012-2025)/ Ligji Nr. 06 L-039 për Sherbimin Gjeologjik të Kosovës/ Dokumentet ekzistuese gjeologjike / si dhe burime të tjera relevante</p>
<p>4. Përpilimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sizmik.</p>	<p>4. Harta vjetore Sizmike, e realizuar</p>	<p>0</p>	<p>1</p>	<p>4. Përpilimi i hartës së shpërndarjes së intensiteti maksimal sizmik për vitin 2024</p>	<p>4.1 Monitorimi dhe mirëmbajtja i rrjetit sizmik;</p> <p>4.2. Analizimi dhe përpunimi i të dhënave sizmologjike dhe përpilimi i hartës vjetore</p>	<p>28098,00 €<sup>4</sup></p>	<p>Ligji Nr. 06 L-039 për Sherbimin Gjeologjik të Kosovës</p>

<sup>3</sup> Buksheti i përfaqësuar për pagave të stafit përkatës të involvuar në projekt (1\*8.3 + 2\*7(S)+1\*4)\* koeficienti për nivel profesional dhe teknik si dhe shpenzimet tjera relevante që kryesisht lidhen me transportin për qëllime të pasurimit...

<sup>4</sup> Buksheti i përfaqësuar për pagave të stafit përkatës të involvuar në kuadër të objektivit (1\*8.3 + 2\*7 S))\* koeficienti \*12).



<p>5. Konsolidimi i mëtejme i kapaciteteve kuadrore, teknike dhe administrative me qëllim të integritimit të SHGJK-së, në iniciativat regjionale për hulumtime gjeologjike</p>	<p>5.1 Digitalizimi i shërbimit dhe zhvillimi i mëtejme i kapaciteteve për vektorizimin e hartave, i realizuar</p> <p>5.2 Funksionalizimi dhe Akreditimi i Laboratori Gjeologjisë, i realizuar</p> <p>5.3. Përfshirja e SHGJK në kuadër të Projektit të GSEU- i realizuar</p>	<p>1</p>	<p>3</p>	<p>5.1 Gjeoreferenci mi dhe digitalizimi përkatësisht vektorizimi i hartave përkatësisht procesimi i të dhënave përmes softuerit ArcGIS</p> <p>me qëllim të gjenerimit të hartave gjeologjike</p> <p>5.2. Zhvillimi i kapaciteteve kuadrore, teknike dhe administrative me qëllim të akreditimit të Laboratorit</p> <p>5.3. Përfshirja e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës në projektin e Shërbimit Gjeologjik Evropian</p>	<p>5.1.1 Zhvillimi i procedurave për furnizim –blerjen e 1 (një) Softuer ArcGIS</p> <p>5.1.2 Trajnimi i stafit me softuer ArcGIS</p> <p>5.2.1 Zhvillimi i procedurave për plotësimi me staf profesional dhe trajnim/ certifikimi sipas standardeve /kriterëve për akreditim</p> <p>5.2.2. Zhvillimi i procedurave per akreditimit sipas rekomandimeve të DAK</p> <p>5.3.1 Definimi i fushave hulumtuese</p> <p>5.3.2 Zhvillimi i procedurave përkatëse dhe nënshkrimi i marrëveshjes</p>	<p>51500,00 €<sup>5</sup></p>	<p>Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (2012-2025)/ Ligji Nr. 06 L-039 për Sherbimin Gjeologjik të Kosovës/ Ligji nr. 05 L-117 për Akreditim/ Dokumentet ekzistuese Gjeologjike si dhe procedurat, standardet tjera relevante</p>
--	---	----------	----------	---	--	-------------------------------	---

<sup>5</sup> Buxheti i përfaqësuar për pagëse se stafit përkatës (1(S)\* koeficienti 1\*12 muaj) + kostot per zhvillimin e procedurave dhe blerjen e licencës së ArcGIS si dhe trajnimin relevant të stafit për përdorimin e tij, si dhe buxheti i përfaqësuar për pagat e stafit përkatës të angazhuar për këto aktivitete. pjesëmarrjen në takimet relevante në kuadër të Shërbimit Gjeologjik Evropian, me qëllim të zhvillimit e procedurave dhe nënshkrimit të marrëveshjes me projektin e GSEU, si zhvillimin e procedurave për trajnim të stafit si dhe pagesa relevante për qëllime të akreditimit sipas rekomandimeve te Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK)